

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Nr 1, Tiranë

PROGRAMI

I KURSIT TË VEÇANTË

**“SHËRBBIM PASTRIMI NË NJËSI BANIMI DHE
INSTITUCIONE ”**

KODI: SHPNJI-20

Miratoi

DREJTOR

.....

Tiranë, 2020

PROGRAMI I KURSIT TË VEÇANTË

“Shërbim pastrimi në njësi banimi dhe institucione”

(SHPNJI-20)

I. Profili Profesional i Punëtorit të shërbimit të pastrimit në njësi banimi dhe institucione.

a) Karakteristikat e Punëtorit të shërbimit të pastrimit në njësi banimi dhe institucione.

Punëtori i shërbimit të pastrimit në njësi banimi dhe institucione është i aftë të kryejë **detyra** profesionale si i punësuar në njësi banimi, institucione apo kompani të ndryshme.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, punëtori i shërbimit të pastrimit në njësi banimi dhe institucione duhet që të zotërojë **njohuri** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë të profesionit, si dhe **shprehje** profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale në fushën e shërbimit dhe ndihmës në familje apo institucione të ndryshme.

Suksesi i shërbimit të pastrimit në njësi banimi dhe institucione është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** (qëndrime) të tilla si: gjakftohësia, shkathtësia, kujdesi, ndershmeria, përqëndrimi, korrektësia, disiplina, etika e komunikimit etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e punëtorit të shërbimit të pastrimit në njësi banimi dhe institucione.

Profesioni i shërbimit të pastrimit në njësi banimi dhe institucione është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për, disinfektim, sterilizim, pastrim, të ndërtesave, të strukturave të ndryshme të apartamenteve, institucioneve dhe ambientet e tyre të jashtme. Ai mund të punësohet në kompani të shërbimeve të pastrimit apo të vetëpunësohet.

Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e punëtorit të shërbimit të kualifikuar. Më pas nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimit nëpërmjet punës, një punëtor i shërbimit mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës në drejtues të punonjësve të shërbimit dhe ndihmës.

Për të zhvilluar aktivitet privat (vetëpunësim) në fushën e punëtorit të shërbimit të pastrimit në njësi banimi dhe institucione dhe shërbimeve të tij, duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “**Punëtorë Shërbimi dhe ndihmës në shtëpi hotele dhe zyra**”, me kod 911 referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për “Shërbim pastrimi në njësi banimi dhe institucione”.

Në përfundim të Kursit për “Shërbim pastrimi në njësi banimi dhe institucione” kursantët do të jenë të aftë të:

- bëjnë organizimin e punës sipas rastit;
- përzgjedhin dhe përdorin mjetet, pajisjet dhe materialet e duhura të punës;
- mirëmbajnë mjetet, materialet, pajisjet dhe mjedisin e punës;
- zbatojnë procedurën e pastrimit sipas standarteve të kërkuara;
- zbatojnë procedurat e dezinfektimit dhe sterilizimit;

- kryejnë pastimin e apartamenteve;
- kryejnë pastrimin e zyrave dhe ambienteve të përbashkëta të institucionit;
- kryejnë pastrimin e ambienteve të jashtme;
- kryejnë pastrimin dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta;
- zbatojnë rregullat e sigurisë në punë, higjienës, dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- zbatojnë standardet e profesionit të punëtorit të shërbimit;
- zbatojnë legjislacionin e punës;
- komunikojnë me etikë profesionale.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për “Shërbim pastrimi në njësi banimi dhe institucione”.

Pjesëmarrësit në Kursin për Shërbim pastrimi në njësi banimi dhe institucione duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për “Shërbim pastrimi në njësi banimi dhe institucione”.

150 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për shërbim pastrimi në njësi banimi dhe institucione.

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e punëtorit të pastrimit në njësi banimi dhe institucione.	SHPNJI-01-20	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan profesionin e punëtorit të shërbimit të pastrimit në njësi banimi dhe institucione. 2. Kursanti përshkruan mjedisin, veglat, pajisjet dhe materialet e punës. 3. Kursanti zbaton legjislacionin, rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.
2	Dezinfektimi dhe sterilizimi.	SHPNJI-02-20	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti kryen dezinfektimin. 2. Kursanti kryen sterilizimin.
3	Shërbime pastrimi në apartamente banimi dhe institucione.	SHPNJI-03-20	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti pastron apartamente banimi. 2. Kursanti pastron ambientet e përbashkëta. 3. Kursanti pastron zyra. 4. Kursanti pastron ambientet e përbashkëta në institucione.

4	Shërbime pastrimi në ambiente të jashtme të gjelbërta.	SHPNJI-04-20	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti pastron ambientet e jashtme. 2. Kursanti mirëmban dhe pastron sipërfaqet e gjelbërta.
----------	--	---------------------	--	--

VI. Vlerësimi dhe Certifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë certifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për shërbim pastrimi në njësi banimi dhe institucione.

1. Moduli “Hyrje në profesionin e punëtorit të shërbimit të pastrimit në njësi banimi dhe institucione”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E PUNËTORIT TË SHËRBIMIT TË PASTRIMIT NË NJËSI BANIMI DHE INSTITUCIONE.	SHPNJI -01-20
Qëllimi i modulit	Një modul teorik që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit në njësi banimi dhe institucione të legjislacionit, sigurisë në punë dhe higjienës.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan profesionin e punëtorit të shërbimit të pastrimit në njësi banimi dhe institucione. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë profesionin e punëtorit të shërbimit të pastrimit në njësi banimi dhe institucione; - të argumentojë etikën e punëtorit të shërbimit të pastrimit në njësi banimi dhe institucione;	

-
- të tregojë rëndësinë e zbatimit të rregullave të qëndrimit dhe komunikimit në mjedisin e punës;
 - të zbatojë rregulla të paraqitjes, higjienës, kujdesit për veten sipas standardeve në mjediset e punës;
 - të zbatojë rregulla të qëndrimit gjatë lëvizjes dhe veprimtarive për ruajtjen e shëndetit;
 - të zbatojë rregullat e komunikimit me etikë profesionale me klientin dhe me të tjerë;
 - të zbatojë rregullat për ruajtjen e privatësisë së klientëve në mjedisin e punës;
 - të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës së punëtorit të shërbimit;
 - të përshkruajë kushtet e punës së punëtorit të shërbimit;
 - të përshkruajë mënyra të organizimit të punës;
 - të shpjegojë mundësitë e karrierës profesionale të punëtorit të shërbimit të pastrimit në njësi banimi dhe institucione.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 2 Kursanti përshkruan mjedisin, veglat, pajisjet dhe materialet e punës.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë mjedisin e një apartamenti, zyre, institucioni, ambienteve të jashtme dhe të gjelbëruara;
- të organizojë dhe mirëmbajë mjedisin e punës së punëtorit të shërbimit;
- të përshkruajë dhe të dallojë veglat, mjetet dhe pajisjet e punës së punëtorit të shërbimit;
- të tregojë përdorimet e veglave, mjeteve dhe pajisjeve të punëtorit të shërbimit;
- të mirëmbajë veglat, mjetet dhe pajisjet e punëtorit të shërbimit;
- të tregojë përdorimet e materialeve të punës në veprimtarinë e punëtorit të shërbimit;
- të interpretojë etiketat dhe udhëzimet e prodhuesit për materialet e punës së punëtorit të shërbimit;
- të sistemojë dhe mirëmbajë materialet e punës së punëtorit të shërbimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 3 Kursanti zbaton legjislacionin, rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë rëndësinë e legjislacionit të punës;

- të përshkruajë rëndësinë që kanë rregullat e sigurimit teknik në punë;
- të përshkruajë masat për mbrojtjen nga dëmtimet që mund të ndodhin në punë;
- të zbatojë rregulla të dhënies së ndihmës së parë në situata të ndryshme gjatë punës;
- të përdorë kutinë e ndihmës së shpejtë;
- të përshkruajë rëndësinë dhe rregullat e mbrojtjes së mjedisit gjatë punës së punëtorit të shërbimit;
- të zbatojë rregullat e higjienës sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

Pyetje - përgjigje me gojë.

Pyetje - përgjigje me shkrim.

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së punëtorit të shërbimit. - Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të punëtorit të shërbimit. - Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet t’iu jepen detyra të përshkruajnë veçoritë e profesionit. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës . - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës. - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

2. Moduli “Dezinfektimi dhe sterilizimi ”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	DEZINFEKTIMI DHE STERILIZIMI	SHPNJI-02-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson kursantët të kryejnë proceset e dezinfektimit dhe sterilizimit.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e punëtorit të shërbimit të pastrimit në njësi banimi dhe institucione”	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM.1 Kursanti kryen dezinfektimin. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : - të përshkruajë ndryshimin ndërmjet pastrimit dhe dezinfektimit; - të përshkruajë procesin e dezinfektimit; - të përzgjedhë mjetet e duhura të punës; - të përzgjedhë produktet e duhura për kryerjen e dezinfektimit; - të përzgjedhë veshjen e duhur për kryerjen e procesit; - të kryejë dezinfektimin e duarve ndërmjet veprimeve të ndryshme përkujdesëse; - të kryejë dezinfektimin e ambientit të brendshëm sipas radhës së punës; - të kryejë dezinfektimin e ambientit të jashtëm sipas radhës së punës; - të kryejë dezinfektimin e ambientit të brendshëm dhe të jashtëm sipas llojit të sipërfaqeve të caktuara; - të kryejë dezinfektimin e sendeve dhe orëndive që ndodhen në ndërtesë dhe jashtë saj; - të sistemojë dhe mirëmbajë vendin dhe mjetet për dezinfektim; - të komunikojë me etikë profesionale; - të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. RM 2 Kursanti kryen sterilizimin. Kriteret e vlerësimit:	

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë ndryshimin ndërmjet pastrimit, eezinfektimit dhe sterilizimit;
- të përzgjedhë veshjen e duhur;
- të përzgjedhë mjetet e duhura të punës;
- të përzgjedhë produktet e duhura për kryerjen e sterilizimit;
- të kryejë pastrimin e duarve ndërmjet veprimeve të ndryshme përkujdesëse;
- të kryejë sterilizimin e ambientit të brendshëm sipas radhës së punës;
- të kryejë sterilizimin e ambientit të jashtëm sipas radhës së punës;
- të kryejë sterilizimin e ambientit të brendshëm dhe të jashtëm sipas llojit të sipërfaqeve të caktuara;
- të kryejë sterilizimin e sendeve dhe orendive që ndodhen në ndërtesë dhe jashtë saj;
- të sistemojë dhe mirëmbajnë vendin dhe mjetet për sterilizim;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së punëtorit të shërbimit. - Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të pastrimit, sterilizimit dhe dezinfektimit. - Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet t’iu jepen detyra praktike për të kryer proceset e sterilizimit dhe dezinfektimit, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. - Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedisë reale të punës në shërbim – pastrimi.

- Komplet i materialeve, veglave, veshje specifike, materiale për realizimin e pastrimit, dezinfektimit dhe sterilizimit
- Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

3. Moduli “Shërbime pastrimi në apartamente banimi dhe institucione”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	SHËRBIME PASTRIMI NË APARTAMENTE BANIMI DHE INSTITUCIONE	SHPNJI-03-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson kursantët për kryerjen e pastrimit të ambienteve të ndryshme si apartamente dhe zyra në institucione të ndryshme.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e punëtorit të shërbimit të pastrimit në njësi banimi dhe institucione” dhe “Dezinfektimi dhe Sterilizimi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti pastron apartamente banimi. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshëndesë pjesetarët e shtëpisë; - të veshë uniformën e punës; - të vendosë rendin e pastrimit; - të përgatisë mjetet dhe pajisjet e punës për pastrim sipas punës që do të kryej; - të përzgjedhë dhe përgatisë solucionet e pastrimit sipas dozave të duhura; - të ajrosë dhomat e apartamentit; - të rregullojë mjedisin e dhomave të apartamentit; - të fshijë dhe lajë dyshtemenë sipas procedurave; - të ndërrojë çarçafët dhe kllefët, të ajrosë dyshekët; - të lajë xhamat e dritareve; - të kryejë pastrimin e dollapeve jashtë dhe brenda; - të sistemojë raftet dhe dollapet; - të hekurosë rrobat; - të kryejë pastrimin e rrobave me furçë; - të vendosë rrobat në garderobë; - të pastrojë ambientin e kuzhinës dhe paisjeve elektrike; - të pastrojë tualetin; - të kryejë spërkatjen me solucion për heqjen e pluhurave, yndyrave dhe mbetjeve të ndryshme në xhama, pasqyra, pllaka, mermere, mure, grila, orendi; - të ruajë nga dëmtimi sendet, orenditë në banesë; - të zbatojë rregullat për ruajtjen e privatësisë së klientëve;	

-
- të zbatojë rregullat e higjienës, sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti pastron ambientet e përbashkëta.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës;
- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e duhura për punë;
- të kontrollojë hapësirën që duhet të pastrojë;
- të vendosë rendin e pastrimit;
- të pastrojë koridoret;
- të pastrojë ashensorët;
- të mirëmbajë mjetet e punës;
- të ruajë nga dëmtimi mjediset, sendet etj.
- të zbatojë rregullat për ruajtjen e privatësisë së klientëve;
- të zbatojë rregullat e higjienës, sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit;
- të komunikojë me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti pastron zyra.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të veshë uniformën e punës;
- të përzgjedhë mjetet dhe pajisjet e punës për pastrim sipas punës që do të kryej;
- të përzgjedhë solucionet e pastrimit, dhe të marrë dozën e duhur pastrim;
- të kryejë pastrimin e zyrave në institucion;
- të zbatojë radhën e punës për pastrimin e zyrave;
- të kryejë spërkatjen me solucion për heqjen e pluhurave;
- të zbatojë procesin e kontrollit për pajisjet në institucion;
- të vendosë në vendin e duhur çdo gjë pasi mbaron punën;
- të raportojë gjëndjen e përgjithshme të punës;
- të pastrojë vendin e punës;
- të mirëmbajë pajisjet e pastrimit;
- të ruajë nga dëmtimi mjediset, orenditë;
- të zbatojë rregullat për ruajtjen e privatësisë së klientëve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit;
- të komunikojë me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM.4 Kursanti pastron ambiebtet e përbashkëta në institucione.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të veshë uniformën e punës;
- të përzgjedhë mjetet dhe pajisjet e punës për pastrim sipas punës që do të kryejë;
- të përzgjedhë solucionet e pastrimit, dhe të marrë dozën e duhur për pastrim;
- të kryejë proceset e pastrimit në koridoret e institucionit;
- të kryejë pastrimin e tualeteve në institucion;
- të raportojë gjëndjen e përgjithshme të punës;
- të pastrojë dhe mirëmbajë vendin, paisjet dhe mjetet e punës;
- të ruajë nga dëmtimi mjediset, objektet dhe orenditë;
- të zbatojë rregullat për ruajtjen e privatësisë së klientëve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit;
- të komunikojë me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së punëtorit të shërbimit. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të punonjësit të shërbimit dhe ndihmës
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet t’iu jepen detyra praktike për të kryer proceset e punës fillimisht të mbikëqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur.
- Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës në shërbim pastrimi - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës. - Veshje specifike, materiale për realizimin e pastrimit, - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
---	---

4.Moduli “Shërbime pastrimi në ambiente të jashtme të gjelbërta ”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	SHËRBIME PASTRIMI NË AMBIENTE TË JASHTME TË GJELBËRTA	SHPNJI-04-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson kursantët për kryerjen e pastrimit të ambjentëve të jashtme të gjelbërta, në ambiente të ndryshme.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e punëtorit të shërbimit të pastrimit në njësi banimi dhe institucione” dhe “Dezinfektimi dhe sterilizimi ”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti pastron ambjentet e jashtme. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën e punës; - të përzgjedhë mjetet dhe pajisjet e punës për pastrim sipas punës që do të kryejë; - të përzgjedhë solucionet e pastrimit, dhe të marrë dozën e duhur për pastrim; - të përdorë kimikatet e duhura, për pastrimin sipas specifikave; - të pastrojë sipërfaqe të jashtme prej guri; - të pastrojë sipërfaqe të jashtme prej metali; - të pastrojë sipërfaqe të jashtme prej xhami; - të pastrojë nga pluhurat dhe të kryejë shkëlqimin e objekteve të drunjtë; - të largojë pluhurat nga të gjitha objektet në lartësi; - të përdorë solucionet e duhura, për pastrimin sipas specifikave; - të bëjë spërkatjen me solucione të ndryshme dhe pastrimin të sipërfaqes së mermertë;	

-
- të bëjë shpëlarjen e sipërfaqes me pompë uji me presion;
 - të pastrojë dhe mirëmban veglat dhe pajisjet e punës;
 - të realizojë detyra të tjera të ngjashme;
 - të ruajë nga dëmtimi mjediset, objektet etj;
 - të zbatojë rregullat për ruajtjen e privatësisë së klientëve;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit;
 - të komunikojë me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti mirëmban dhe pastron sipërfaqet e gjelbërta.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës;
- të përshkruajë mjete e punës dhe përdorimet e tyre;
- të përzgjedhë mjetet dhe pajisjet sipas punës që do të kryejë;
- të pastrojë me krehër ose me fshesë papastërtitë e ndryshme (gjethë të thata të rëna nga bimësia përrreth) në sipërfaqet e gjelbërta);
- të ujisë sipërfaqen sipas nevojës;
- të mirëmbajë lulet;
- të pastrojë barërat e keqija;
- të ruajë nga dëmtimi mjediset, objektet etj;
- të zbatojë rregullat për ruajtjen e privatësisë së klientëve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit;
- të komunikojë me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së punëtorit të shërbimit. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të punonjësit të shërbimit dhe ndihmës
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet t'iu jepen detyra praktike për të kryer proceset punës fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur.

	- Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës në shërbim pastrimi - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës. - Veshje specifike, materiale për realizimin e pastrimit, - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesat, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.